



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DREJTORIA JURIDIKE E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURES: "FV Blerje Tableta dhe Printera Termik"

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 30232110-8 30213200-7

Vlera e Fondit Limit: 4.371.391 (katër milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH

Afati kohor për dorëzimin e ofertave: 10 (dhjetë ditë) sipas Nenit 49, pika 3 e Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ku përcaktohet se "Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës"

Procedura e këtij prokurimi është: Procedure e hapur e thjeshtuar

Kohëzgjatja në muaj: Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të të prokurimit prok publik", autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit ka

hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kriterë duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

b.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.*

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve në Shtojcën 9, të Dokumentave Standarte të Tenderit “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se : *” Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”c” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.26, datë 08.09.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Është kërkuar që furnizimet e ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit që është brenda kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar në rregullat e prokurimit publik. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë

realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin publik apo privat.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi, për mallrat objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, të paraqitet edhe dokumentacion ligjor i vlefshëm që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton origjinalitetin e mallrave të furnizuara objekt i kësaj procedure prokurimi, dhe rrjedhimisht mund tju kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të dokumentacion ky i cili mund të jetë direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar prej tij. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkojnë të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke garantuar edhe gjatë periudhës së garancisë mbështetjen e kompanisë prodhuese/distributore gjatë procesit të furnizimit/instalimit dhe mirëmbajtjes, me qëllim verifikimin e origjinës së mallrave.

Gjithashtu kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimet e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/broshurë/skede teknike, nga firma prodhuese për pajisjet që ofron për këtë objekt prokurimi. Në Katalogun/broshurën/skedën teknike të shënohen në mënyrë të dukshme lloji i pajisjes së ofruar, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 6 b) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve të mallrave objekt prokurimi i shërben Autoritetit Kontraktor për të vlerësuar përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesmarrës me produktin/tet dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK, pra qëllimi i këtij kriteri është vërtetimi nga ana e operatorit ekonomik se

paisja që do të ofrohet i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor duke bërë krahasimin ndërmjet tyre.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001-2015 (ose e përditësuar) mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36, nenit 77, nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin.

Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

2.3.5 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e “Tabletëve” që do të ofertohen, ose ekuivalent, të lëshuar nga institucionet e autorizuar të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, apo nga distributori i autorizuar.
- Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e “Printerave Termik Portabël” që do të ofertohen, ose ekuivalent, të lëshuar nga institucionet e autorizuar të akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, apo nga distributori i autorizuar.

Për këtë provuar këtë kriter të paraqiten:

- Certifikata e trajnimit.
- Kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.
- Listëpagesat e shoqërise për të paktën tre muajt e fundit (nga momenti i zhvillimit të procedurës) në të cilat specialistet e siperpermendur duhet të figurojnë të regjistruar, sipas formatit E-Sig 025/a.

* Shënim. Një specialist mund të zotërojë më shumë se një certifikatë teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1 dhe 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërmat b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme, stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Neni 77 i Ligjit 162/2020 : *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) **aftësinë teknike dhe profesionale.***

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe **aftësitë teknike e profesionale** për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Nga ana e specialistit të fushës, pjesë përbërse e njësisë së prokurimit, vlerësohet se është e domosdoshme që mbështetur në specifikimet teknike dhe afatin e realizimit të furnizimit dhe vendosjes së pajisjeve 34 copë **Tabletë** dhe 34 copë **Printera Termikë Portabël** ku duhet të çiftohen/instalohen për çdo tablet nga një printer termik, operatorët ekonomikë të disponojnë minimalisht një staf të mjaftueshëm të certifikuar, për të garantuar ekzekutimin me sukses të procesit, cilësinë e punës dhe të ofrojnë garancine përgjatë periudhës së parashikuar sipas specifikimeve teknike.

- a) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e “Tabletëve” që do të ofertohen, ose ekuivalent të lëshuar nga institucionet e autorizuar te akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, apo nga distributori i autorizuar.

Argumentimi: Rëndësia e këtij specialisti është thelbësore për realizimin me sukses të instalimit dhe konfigurimit të tabletëve. Kjo pasi tabletët do të startohen, do t’u vendosen account specifike, do të vendoset aplikacioni ekzistues mbi të cilin do të punojnë dhe do të lidhen me Printerin Termik Portabël. Në fund do të testohet lidhja dhe do të printohet një faqe test. Disponueshmëria e një specialisti të certifikuar e garanton realizimin me sukses të këtij procesi dhe siguron suportin për gjatë gjithë periudhës së garancisë.

- b) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e “Printerave Termik Portabël” që do të ofertohen, ose ekuivalent të lëshuar nga institucionet e autorizuar te akredituara nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, apo nga distributori i autorizuar.

Argumentimi: Rëndësia e këtij specialisti është thelbësore për realizimin me sukses të instalimit dhe konfigurimit të printerave termike portabël. Kjo pasi printerat do të startohen, do t’u vendoset media specifike mbi të cilën do të printohet, dhe do të lidhen me tabletin respektiv. Në fund do të testohet lidhja dhe do të printohet një faqe test. Disponueshmëria e një specialisti të certifikuar e garanton realizimin me sukses të këtij procesi dhe siguron suportin për gjatë gjithë periudhës së garancisë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se garanton minimumi një vit garanci për secilën nga pajisjet objekt prokurimi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mjetet e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që mallrat objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues

Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Sa më sipër, specifikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt "FV Blerje Tableta dhe Printera Termik", Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.